



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 721 Dt. 19.12.2022
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe në bazë të kërkesës për inicim te procedurës disiplinore nga Komisioni i Garave, Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 19.12.2022 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME kërkesa e Komisionit të Garave të FBK-së e datës 30.11.2022.
- II. SHQIPTOHET dënim me një ndeshje mos-paraqitje për Lindrit Misinin (zyrtar i KB Trepça), konform nenit 50.9 të Propozicioneve të Garave të FBK-së.

ARSYETIM

Me datë 30.11.2022, Komisioni Disiplinor (KD), përmes postës elektronike, nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore (Kërkesa), e parashtruar nga Komisioni i Garave të FBK-së, lidhur me incidentin në ndeshjen mes KB Trepça dhe KB Peja, xhiroja XII e Prince Caffè Superligës së Kosovës (edicioni 2022/23).

Incidenti në fjalë ka të bëjë me trazirat gjatë ndeshjes së cekur, ku supozohet se, gjatë hyrjes në zhyeshtore, është goditur në tunel Arbër Elshani (anëtar i kryesisë KB Peja) nga Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës).

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 19.12.2022. Në takim kanë qenë prezent anëtarët e KD: Omer Daku (Kryetar), Armend Hamiti (Anëtar), Blerim Vuniqi (Anëtar), si dhe në përputhshmëri me nenin 37 të Rregullores Disiplinore, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

Para takimit, Sekretarja e Përgjithshme e FBK është autorizuar nga KD për të kërkuar deklaratat nga akterët e përfshirë në këtë rast. Këta të fundit kanë dërguar deklaratat nga personat e përfshirë, përkatësisht nga Arbër Elshani (Drejtor Gjeneral i KB Peja), Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës) dhe tre dëshmitarë nga KB Trepça (të cilët kanë qenë prezent në ndeshje).

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Komisioni Disiplinor, gjatë trajtimit të incidentit, ka shqyrtuar provat dhe dokumentet në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

1. Kompetenca e KD për të shqyrtuar rastin

Pas shqyrtimit të incidentit nga Komisioni i Garave të FBK-së, është konstatuar se kundërvajtja shkon përtej kompetencave të Komisionit të Garave, pasi që Lindrit Misini nuk ka qenë e paraqitur në listën paraqitëse (zyrtare/protokoll) të ndeshjes KB Trepça – KB Peja në kuadër të xhiros së XII-të të Prince Caffè Superligës së Kosovës.

Megjithatë, Lindrit Misini është zyrtar i KB Trepça i paraqitur në dokumentacionin e KB Trepça në Federatën e Basketbollit të Kosovës, dhe duke u thirrë në nenin 4 dhe 33 të Rregullores Disiplinore, është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka kompetencë të shqyrtojë kërkesën nga Komisioni i Garave të FBK-së.

2. Meritat e Vendimit

Fillimisht, si prova në shqyrtimin e incidentit në fjalë, kanë shërbyer: deklaratat nga dy personat e përfshirë, foto nga Arbër Elshani, dhe video nga transmetimi i ndeshjes.

Pas pranimit të deklaratave (01.12.2022 dhe 02.12.2022), Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar provat në dispozicion dhe ka ardhur në përfundim se ato nuk mjaftojnë për të marrë vendim përfundimtar. Si rrjedhojë, në bazë të nenit 39 të Rregullores Disiplinore, deri në marrjen e vendimit final, Lindrit Misinit i'u shqiptua pezullimi 7 ditë nga pozita e tij si zyrtar i paraqitur në dokumentacionin e KB Trepça në FBK.

Komisioni Disiplinor autorizoi Sekretaren e Përgjithshme të kërkojë deklarata apo prova shtesë nga të dy klubet e përfshira, pas së cilës KB Trepça ka dërguar deklarata nga tre dëshmitarë lidhur me incidentin.

Në mbledhjen e mbajtur më 19.12.2022, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar sipas bindjes së lirë në bazë të provave në dispozicion.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Neni 50.9. i Propozicioneve të Garave të FBK-së parasheh dënimet për pjesëtarët e ekipeve, dhe dënon me një (1) ndeshje sjelljen josportive të 'konstatuar në bazë të fletëparaqitjes nga personat zyrtarë, transmetimi televiziv, xhirimet apo e shfaqur në prezencë të Komesarit të Garave, cilitdo anëtar të Komisionit të Garave, Sekretarit apo Kryetarit të FBK-së'.

Në mangësi të provave që vërtetojnë se Lindrit Misini ka sulmuar fizikisht Arbër Elshanin, Komisioni ka konstatuar se, duke u bazuar në transmetimin televiziv shihet se Lindrit Misini e tërheq në mënyrë të vrazhdë Arbër Elshanin në drejtim të zhveshtoreve, kurse goditja vjen nga publiku (bazuar në xhirimin e poseduar).

Bazuar në nenin 50.9. të Propozicioneve të Garave, dhe në provat në dispozicion, Komisioni Disiplinor ka ardhur në përfundim se Lindrit Misinit, si rrjedhojë e incidentit në fjalë, i shqiptohet dënimi me një (1) ndeshje mosparaqitje si person zyrtar i KB Trepça.

Armend Hamiti
Anëtar

KOMISIONI DISIPLINOR :

Omer Daku
Kryetar

Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 19 Dhjetor 2022



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Vendimi i dërgohet:

- KB Trepça
- KB Peja
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së
- Komisionit të Garave
- Arkivit të FBK-së

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

